



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1169 / Prot

Tiranë, më 01/12/2015

Lënda: Mendim për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar.

Drejtuar: Znj. Milena HARITO
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE

Tiranë

E nderuar znj. Harito,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 5317 Prot, datë 06.11.2015, në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike” i ndryshuar, do të kërkonim nga ana juaj disa përshtatje si vijon.

Pas nenit 1 të projektligjit shtohet një nen me këtë përmbajtje:

Neni (...)

Shkronja b) e pikës 2 të nenit 2 shfuqizohet.

Në nenin 3 të projektligjit bëhet një shtesë:

Pas shkronjës ë) të pikës 2 të nenin 5, shtohet një shkronjë me këtë përmbajtje:

“Të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të marrësve të shërbimit dhe konsumatorëve”.

Në nenin 4 të projektligjit togfjalëshi “...të pikës 1 të këtij neni...” zëvendësohet me “...të parashikuara në këtë nen...”

Pas nenit 4 të projektligjit shtohet një nen me këtë përmbajtje:

Neni (...)

Pas shkronjës ç) të nenit 8, shtohet një shkronjë me këtë përmbajtje:

“Kryhen pas informimit të marrësve të shërbimeve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në nenin 5 të projektligjit, bëhet 1 shtesë me këtë përmbajtje:

Në fund të nenit 9, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Rregulla të hollësishme në lidhje me regjistrin e përjashtimeve për komunikimet e pakërkuara prej marrësve të shërbimeve, persona fizik, përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale”.

Zyra e Komisionerit është duke punuar për hartimin e kuadrit regullator dhe teknik për ngritjen e një Regjistri Kombëtar të thirrjeve (komunikimeve) të pakërkuara (“National Do Not Call List Register”). Eksperiencia ndërkombëtare e ka kërkuar që është më efektiv krijimi i një regjistri të vetëm për të menaxhuar në mënyrë më të përqëndruar regjistrin e përjashtimeve nga thirrjet e padëshiruara ose pa marrë pëlqimin paraprak të subjekteve të të dhënave. Kjo është një praktikë e aplikuar në mënyrë efektive në disa vende të BE, si Britani e Madhe, Francë, Itali, etj. Në terma praktikë, kjo nënkupton krijimin e një regjistri kombëtar ku qytetarët regjistrohen duke zgjedhur të mos kontaktohen për marketing me qëllime komerciale, promovionale apo kërkimore në numrin e telefonit, me sms ose nëpërmjet postës elektronike. Ky është një shërbim i ri projektuar për të mbrojtur qytetarët, që nuk dëshirojnë të marrin telefonata, sms për qëllime komerciale apo studime tregu dhe në të njëjtën kohë, është një mjet për ta bërë tregun më konkurrues, dinamik dhe transparent midis operatorëve të marketingut telefonik. Kjo vjen edhe si një diktim nga praktika e punës së Zyrës së Komisionerit dhe numrit të madh të ankesave nga ana e subjekteve të të dhënave në këtë drejtim.

Ky regjistër menaxhohet nga një Autoritet i vetëm, çfarë bën të mundur menaxhimin në mënyrë më efektive të tij dhe në çdo rast subjekti i të dhënave ka të drejtën e ankimit pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky parashikim nuk bie në kundërshtim dhe nuk pengon gjithsesi, që ofruesit e shërbimeve të mbajnë regjistrin e përjashtimeve sipas parashikimeve të nenit 9, parag.3 të ligjit nr. 10128 “Për komunikimet elektronike”.

Me kryerjen e përshtatjeve të mësipërme, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike” i ndryshuar, vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
